




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE “BEQIR ÇELA” DURRËS



Nr. 36 prot.

Data. 23.06.2025

Lënda : Njoftim për vënd të lire pune

Drejtuar: DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMËVE NJERËZORE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”; të udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njesisë së zhvillimit të institucionëve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të përsoneleit”.

Ofruesi publik I AFP-së Shkolla profesionale “Beqir Çela”, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

1. Teknik I mesëm (mirëmbajtës I kaldajës, paisjeve etj) - 1 (një) vend vakant.

A - Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

1. Kriteret e përgjithshme:

Aplikanti duhet të përmbushë këto kritere:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;

- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2. Krite të posaçme për sekretar shkolle, magazinier, punonjës pastrimi, punonjës I sigurisë I sigurisë (roje), punonjës ndihmës:

- a) të ketë nivelin arsimor të mesëm ose shkollë të mesme profesionale, në fushën në shpalljen për pozicionin përkatës;
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë në punë sipas përcaktimëve në shpalljen për pozicionin përkatës;

B - Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
 - b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;
 - c) kartën e identitetit;
 - d) diplomën/dëftesën;
 - e) librezën e punës;
 - f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
 - i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
 - i) vërtetim banimi
- ✓ Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.
 - ✓ Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda dates 02.07.2025

Drejtor

Fatmir Merkuri

